

GJOVALIN PREÇI



Kryeauditues në KLSH, në Departamentin e Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Lindur në vitin 1962. Diplomuar në Ekonomi, dega Plan(1986). “Master” në Universitetin Bujqësor të Kamzës(2006). 26 vite eksperience pune. 5 vitet e fundit si auditues në KLSH.

Nga shtatori 2013, Kryeauditues. Fusha e ekspertizes: Menaxhimi i sigurimeve shoqërore dhe pensione

SHOQËRITË PUBLIKE NË SKANERIN E KLSHⁱⁱⁱ

nga Gjovalin Preçi

Një nga misionet e Kontrollit të Lartë të Shtetit është auditimi i ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësim i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërive anonime me kapital tërësisht shtetëror dhe shoqërive të përbashkëta, ku shteti zotëron paketën kontrolluese të aksioneve prej 51 %, në kuadër të kontrollit të administrimit të pronës shtetërore. Regjimi juridik i ndërmarrjeve shtetërore është i tillë që, në përputhje me objektin e parashikuar në aktin e krijimit të tyre ushtrojnë veprimtari prodhimi (si KESH Sha etj.), tregtie dhe shërbimi (si Ndërmarrjet e Ujësjellës-Kanalizimeve duke përfshirë dhe prodhimin e ujit etj.) duke pasur si qëllim realizimin e fitimit, shtimin e pasurisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Numri i shoqërive publike në vendin tonë ka ardhur duke u reduktuar, si pasojë e procesit të privatizimit, ndonëse me ritme të ngadalësuara në vitet e fundit si rezultat i shumë faktorëve, si dhe të falimentimit të atyre degëve që nuk i janë përgjigjur dot ndryshimeve strukturore në ekonominë shqiptare. Megjithatë shteti ende ruan një pjesë të

konsiderueshme pronësie në disa degë të ekonomisë duke i dominuar ato si: transporti hekurudhor, ujësjellës-kanalizime, prodhimin e hidrokarbureve, prodhimin dhe transmetimin e energjisë elektrike etj. Sipas INSTAT-it për vitin 2011 në sektorin shtetëror jobuxhetor kanë qenë të angazhuar 36,900 punonjës ose 22.3 % e sektorit shtetëror, ndërsa paga mesatare mujore për ekonominë në tërësi ka qenë 36,482 lekë, në sektorin publik ishte 46,665 lekë ose 27.9% më e lartë. Megjithëse nuk zënë një përqindje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve përfshirë dhe ato private, shoqëritë aksionere përbëjnë pa asnjë dyshim pjesën më dinamike të bizneseve private e publike, të cilat japin kontribut të rëndësishëm në prodhimin e përgjithshëm bruto të ekonomisë shqiptare, në rritjen ekonomike, në investimet dhe në zgjerimin e vendeve të punës.

Për arritjen e rezultateve të programuara nga shoqëritë dhe ndërmarrjet publike, pra në tërësi për entet publike dhe kryerjen e aktivitetit në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse, është e interesuar shoqëria në tërësi, pasi këto janë pronë shtetërore dhe si e tillë duhet të jenë transparente dhe efektive në veprimtarinë e tyre. Rritjes së efektivitetit nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e situatës në drejtim të menaxhimit, administrimit dhe organizimit, duke marrë masa për shmangien e shkeljeve të konstatuara për të ardhmen, por dhe duke vënë para përgjegjësisë materiale dhe sipas rastit dhe penale shkaktarët e dëmtimeve të aseteve, i ka shërbyer veprimtaria audituese e KLSH në shoqëritë publike.

Natyrisht shteti, sikurse edhe çdo pronar tjetër privat ka të drejta të plota për të vendosur për treguesit ekonomik dhe financiar të shoqërisë apo ndërmarrjes publike lidhur me: të ardhurat vjetore, shpenzimet gjithsej dhe nga këto për pagat, investimet, numrin e fuqisë punëtore, pagën mesatare vjetore etj. Krahas mangësive në cilësinë e përgatitjes e tyre vërehen shkelje në afatet e parashikuara ligjore për hartimin e programeve ekonomiko-

financiare të zhvillimit të tyre. Në përgjithësi nuk ka një harmonizim dhe bashkërendim të punës për hartimin e treguesve të këtij programi midis drejtorive brenda shoqërisë, duke e konsideruar një veprimtari rutinë të tyre. Shoqëritë dhe ndërmarrjet publike në hartimin e programeve vjetore nuk kanë ose nuk mbështeten sa duhet në planet strategjike afatgjata dhe programet afatshkurtëra, duke kërkuar për këtë qëllim dhe miratimin nga ministrinë e linjës dhe jo vetëm të Ministrisë së Ekonomisë në cilësinë e pronarit. Veç këtyre, kjo ministri ka lejuar ndryshime të vazhdueshme të programeve ekonomike gjatë vitit, duke prishur balancën edhe të atyre programeve që në ndonjë rast kanë qenë optimal për nga përgatitja. Mangësitë e mësipërme duke u bashkuar me mungesën e thelluar të raportimeve dhe analizave periodike nga drejtoritë dhe bordet drejtuese, bëjnë që niveli i realizimit të programeve ekonomike dhe financiare të jetë i ulët dhe performanca menaxhuese të shfaq mangësi dhe të meta.

Në të shumtën e rasteve jo më pak mangësi shfaqin bordet e shoqërive dhe ndërmarrjeve publike: këshillat mbikëqyrëse dhe ato drejtuese. Bordet trajtohen si organe pa shumë përgjegjësi, pa iniciativë, shtojca të administratës së shoqërive, me status të kufizuar dhe që mund të ndryshohen sa herë që ndryshojnë drejtuesit politikë të dikastereve. Organizimi dhe funksionimi ligjor i organeve drejtuese janë çështje të auditimit të shoqërive publike. Këshillat drejtues apo mbikëqyrëse në të shumtën e rasteve nuk përmbushin kriteret ligjore të cilësisë së përbërjes duke e konsideruar si burim shtesë të ardhurash për individë të pushtetshëm të radhës, sesa si menaxherë në administrimin e shoqërisë. Duke qenë të tillë, në mjaft raste largohen pa përmbushur afatet dhe shkaqet ligjore të qëndrimit, largimit dhe të zëvendësimit, duke mos respektuar dhe kërkesat numrin e mbledhjeve dhe tematikën e çështjeve për të cilat këto borde janë përgjegjës ligjërisht. Vendimeve të marra, në mjaft raste u mungon referenca ligjore ose dalin

jashtë kompetencave të tyre 1. Po kështu edhe drejtuesit ekzekutivë shpesh marrin vendime të kundërligjshme si në lidhje me largimet nga puna copëzimin e prokurimeve në rolin e autoritetit kontraktor, paaftësi në realizimin e treguesve të programuar etj. Në përgjithësi konstatohet miratimi i vendimeve të nxituara e të pabazuara ligjërisht mosmarrja në analize dhe shqyrtimi periodikisht i veprimtarisë së shoqërisë dhe moszbatimi i detyrimit statutor për raportimin në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, ndonëse dhe kjo fundit nuk insiston në marrjen e raportimeve mbi ecurinë e menaxhimit të shoqërive publike. Ndryshe nga vitet e mëparshme, KLSH gjatë auditimeve të veta ka kërkuar marrjen e masave disiplinore për nivelin e lartë drejtues, përfshirë dhe këshillat mbikëqyrëse dhe drejtuese të shoqërive publike për performancë të dobët në menaxhimin e këtyre aseteve. Fusha e pagave dhe shpërblimeve për nga madhësia e shpenzimeve në shoqëri që përgjithësisht i kalon 40-50% të shpenzimeve gjithsej, kjo në varësi të objektit të veprimtarisë, përbën një zonë të konsiderueshme rrisht gjatë kontrollit të shoqërive publike. Problematika më e madhe shfaqet në shoqëritë publike financiarisht të dobëta (si Ujësjetës etj.) në lidhje me shpërblimin në fund të vitit, ku edhe pse shoqëria rezulton me humbje, vazhdojnë të marrin pagesa në fund të vitit, duke u “tretur” ndikimi stimulues i shpërblimit, si dhe duke rritur nivelin e humbjeve. Mangësitë në dokumentacionin përkatës në disa raste nivelet e larta të pagesave apo mangësitë në dokumentacionin e subjekteve të sponsorizuara përbëjnë problematiken më të përgjithshme në këtë çështje, për të cilat KLSH krahas masave organizative, ka rekomanduar masa zhdëmtimi si dhe masa disiplinore.

Në fushën e menaxhimit financiar janë vërejtur abuzime në shpenzimet për personelin, mungesë të dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë apo me anë të bankës, abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit

të valutës, mos shlyerje në afat e detyrimeve të ndryshme, mungesën e manualeve për procedurat e vendosjes së likuiditeteve në depozita etj., për të cilat KLSH në çdo rast ka evidentuar shkallën e përfshirjes së personave përgjegjës dhe ka rekomanduar masa për ndëshkimin e tyre. Në këtë çështje KLSH konstaton se edhe ekspertët kontabël të miratuar të cilët bëjnë certifikimin e bilanceve vjetore, nuk tregohen të vëmendshëm në dhënie të opinionit të tyre, pasi ka raste kur mungon inventarizimi vjetor i aseteve apo mangësi që evidentohen nga auditimet e tjera dhe që nuk gjejnë pasqyrim ose nuk ndikojnë në dhënie të opinionit për to.

Gjendja, evidentimi, ndjekja sistemimi dhe arkëtimi i debi-kredive rezultojnë të jete problematik pothuajse në të gjitha subjektet juridike publike. Ka raste kur nuk janë konsumuar në afat të gjitha rrugët për vjeljen e detyrimeve debitore deri në ngritjen e padive në gjykatë për persona fizik apo juridik me detyrime të pashlyera. Gjithashtu, janë evidentuar raste të moslikuidimit në afat të klientëve, edhe pse shoqëria ka pasur disponibilitet të likuiditeteve për të mos lejuar krijimin e detyrimeve kreditore. Në mjaft raste këto çështje nuk janë marrë në analizë në mënyrë të vazhdueshme nga këshillat mbikëqyrëse dhe drejtuese për të evidentuar përgjegjësitë dhe ndëshkuar shkaktarët dhe për më tepër duke ndikuar kështu në uljen e këtyre detyrimeve dhe parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj.

Është e rëndësishme të theksohet se shoqëritë dhe ndërmarrjet publike, akoma nuk kanë arritur të zbatojnë plotësisht si duhet ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të cilat janë “busulla” orientuese e stafeve drejtuese në administrimin ekonomik, financiar dhe ligjor të tyre.

Kryerja e prokurimeve në mënyrë elektronike ka zvogëluar mundësinë e ndërhyrjeve dhe është rritur konkurrenca, Megjithatë konstatohet se shoqëritë publike, në cilësinë e autoritetit kontraktor nuk hartojnë dhe raportojnë periodikisht procedurat e prokurimeve, si dhe nuk parashikojnë procedurat e blerjeve me vlera të vogla, duke sjellë copëzimin e tyre dhe duke kaluar vlerën limit prej 400 mijë lekë në vit. Për mungesë të informacionit dhe hapësirave që lë ligji, vazhdon të mbetet problem përcaktimi i fondit limit për prokurim në vlera të larta, ose vendosja e kushteve të përgjithshme dhe specifike kufizuese duke paracaktuar fituesin në një far mënyre (kjo kryesisht për punë dhe mallra elektronik dhe shërbimin e sigurisë fizike dhe të objekteve) ose duke lënë hapësira për pjesëmarrje dhe të subjekteve që nuk janë potencialisht të suksesshme (rastet e tenderimit të karburanteve) etj. Ndryshimet e fundit ligjore në procedurat e prokurimit publik me ndëshkimin me gjoba të larta të aktorëve pjesëmarrës në këto procedura do të vështirësojë ndërhyrjet nga lart, duke siguruar prokurime me oferta ekonomikisht më të favorshme. Mungesa e kapaciteteve përkatëse prokuroese në shoqëritë publike bën që mangësitë të shfaqen në procedura dhe në zbatimin me mangësi të prokurimeve kryesisht në fushën e ndërtimeve dhe mosrealizimin në afat të kontratave etj.

Në vitet e fundit ka marrë përmasa më të gjera fenomeni i ndëshkimit nga gjykata të shoqërive publike me gjoba, si rezultat i largimit të punonjësve pa shkaqe të përligjura, në kundërshtim me kodin e punës, duke sjellë rritje të panevojshme të shpenzimeve dhe ulje të derdhjes së detyrimeve tatimore. Veprime të tilla nga ana e drejtuesve të shoqërive publike, kanë bërë që të shtohen elementët ndëshkues ndaj tyre në raportet finale të auditimit.

KLSH, kohët e fundit e i ka dhënë një vlerësim të veçantë çështjeve që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e auditit të brendshëm në shoqëritë publike. Kjo për vetë faktin se ekzistenca e specialistëve të aftë, të ndershëm

dhe profesional në administrimin financiar të shoqërisë dhe njësia e auditit të brendshëm në funksion të plotë në përputhje me ligjin zvogëlojnë ndjeshëm nivelin e riskut të abuzimeve.

Veprimtaria audituese e KLSH në shoqëritë publike pasqyrohet nëpërmjet dokumenteve të auditimit, të cilat në mënyrën e përmirësuar të raportimit kanë rritur përgjegjshmërinë audituesve për të qenë objektiv, profesional, të saktë dhe të paanshëm, në zbatim të Deklaratës së Limës e cila përcakton që, raportet duhet të paraqesin faktet dhe të jenë sa më të saktë dhe të lehtë për t'u kuptuar, si dhe vlerësimi i tyre të bëhet në mënyrë objektive (neni 17, pikat 1), si dhe duke siguruar rekomandime për organet shtetërore dhe përdoruesit e tjerë të fondeve publike për përmirësimin e veprimtarisë së tyre.

Është kërkesë e kohës që shoqëritë publike të ndjekin parimet për një qeverisje të mirë, që do të thotë njohje, respektim dhe zbatim i ligjeve, si dhe një kulturë të lartë manaxhimi, me elementë kryesorë të saj: përgjegjësinë, ndershmërinë, konfidencialitetin dhe transparencën, për të rritur sigurinë, integritetin dhe eficiencën e tregut, duke ndihmuar kështu në rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit.

ⁱ Botuar në Gazetën "Metropol" dt. 27 Gusht, 2013

ⁱⁱ Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- KLSH dhe mirëqeverisja (Metropol, 16 maj 2013)
- Roli i KLSH në rritjen e financimeve të huaja (Tirana Observer 18 gusht 2013)